


M.A.D
magazine
3 multimedia-art.design



Prof. Dr. Besnik Aliaj



CONTENT

1. PARATHËNIE	8
2. VIDEOJA MUZIKORE	16
3. HISTORIA DHE ZHVILLIMI	22
4. INOVACIONI VIZUAL 1960-1967	30
5. KLIPET PROMOCIONALE 1967-1973	38
6. FILLIMET E TELEVISIONIT MUZIKOR 1974-1980	50
7. VIDEOT MUZIKORE PËRHAPEN NË MASË 1981-1991	62
8. SUKSESI I REGJIZORËVE 1992-2004	72
9. INTERNETI BËHET VIDEO-MIQESOR 2005-2013	76
10. MUZIKA COUNTRY	86
11. VIDEOT MUZIKORE JOZYRTARE	90
12. ÇENSURIMI	94

PARATHËNIE

Kënga dhe videoklipi *"Video Killed Radio Stars"* nga grupi muzikor Buggles (UK) përbën një kujtim të hershëm të adoleshencës sime, në kohën kur gjatë regjimit komunist në Shqipëri dëgjohej e shikohej fshehtas në valët e RAI-t, emisioni mjaft popullor i kohës *"Hit Parade Countdown"* zakonisht të premtën, të shtunën dhe të dielave në mesditë...

Vite më vonë do të sensibilizohesha se ajo këngë dhe videoklipi i saj mjaft popullor do të ishin më shumë se një hit i ditës. Ajo në fakt përbënte një risi dhe një moment kulmor për fillesat e artit të imazhit lëvizës e të *"new media-s"* në tërësi. Ishte momenti kur muzika u shkëput nga varësia e performacës në skena dhe do të evolonte drejt teknikave të trasmetimit në televizione, videokaseta, kompjutera, dhe në mediat online...

Ky kapërcim kulturor dhe mental i shoqërisë u reflektua fort në komunitetin e artit duke *"martuar"* dy zhanre: muzikën (performanca) dhe videon (imazhi), e duke krijuar një hapësirë të madhe pune dhe lirie shprehje për artistët e aplikuar, performuesit dhe dezainerat. Ndaj, kur në vitet 2000 do të ndërmerrnim iniciativën e krijimit të programit mësimor të Artit dhe Dezainit të Aplikuar,



Fq. 6: Kopertina të albumeve të grupeve The Rolling Stones, The Animals, Sex Pistols; Anash: Rreklamë e grupit The Buggles

gjithë përkushtimi ynë u vendos drejt identifikimit të një kurrikule dhe stafit me kapacitete të nevojshme për këtë profil unikal në vend.

Si dhe kolegë të tjerë, edhe unë jam përpjekur të kontribuoj për vendosjen e gurëve të themelit teorik dhe praktik të këtij profil. Ndaj para një viti jam rrekur të zhvilloj një leksion që trajtonte pikërisht këtë marrëdhënie midis imazhit dhe performancës muzikore, kalimin nga pentagramet tek grafika vizuale. Kërkimi online (këtu përfshihet një analizë e plotë e materilave të shkruara dhe mbi 200 videoklipe e filma në Youtube e Wikipedia) si dhe në bibliotekën e U_POLIS, më çuan drejt një leksioni për rolin e dizajnit në industrinë e muzikës dhe videos. Është një histori e mahnitshme, të cilën e përjetojmë çdo ditë dhe nuk kuptojmë se është një nga shtesat më ilustruese të vetë evolucionit e trendeve të shoqërisë njerëzore dhe të marrëdhënieve tona në tërësi.

Kjo ndjesi më shtyu që leksionin fillestar, i cili u prit me shumë interes, ta çoj drejt një projekti të mirëfilltë ku përfshihen një botim dhe ndoshta një ekspozitë me titullin domethënës "Video Killed Radio Star – Një vështrim i marrëdhënieve dhe rolit të dizajnit me industrinë e prodhimit të muzikës dhe videoklipit", të cilin e mundësoi MAD (Multimedia Art Design) Center & Gallery pranë Universitetit

POLIS. Përmes kësaj parathënie dua të njoh edhe kontributin dhe të falenderoj për ndihmën e jashtëzakonshme të studentes Julia Janku, sidomos për kërkimin grafik, faqosjen e këtij botimi dhe përkthimin e materialeve të caktuara.

Unë shpresoj se ky material do të ketë vlerë jo thjesht informues për studentët e fushave të artit, dizainit, arkitekturës, por edhe më gjerë, për të apasionuarit e kësaj teme. Mbi të gjitha shpresoj që ky material të jetë një kontribut sado modest në përpjekjet për të kultivuar në vend një kulturë të re të shprehuri dhe jetuari. Kjo bëhet edhe më jetike në kushtet e rrezikut të imponimit të kulturës turbo në ekonomi, urbanistikë, arkitekturë, arte, etj. Edhe Shqipëria pas viteve 90-të është më e ekspozuar ndaj sfidave të globalizimit, por edhe ndaj keqinterpretimeve dhe versioneve banale lokale të artit e kulturës.

Madje edhe në Shqipëri ndihet evolucioni global e sidomos ai amerikan i industrisë globale të muzikës dhe videoklipit. Pas depërtimit të MTV, Vevo, VH1, në ekranet tona në fillim të viteve 90-të si shenjë e hapjes dhe lirisë, përtej vitit 97-të në tregun vendas dolën në skenë edhe kanalet e para të prodhimit e transmetimit të videoklipeve shqiptare, përfshi: *BBF, Top Channel, Digitalb*, si dhe një

sërë festivalesh e çmimesh alternative muzikore, që do të thyenin një herë e përgjithmonë monopolin e televizionit publik RTSH.

Aktualisht në vend është krijuar e konsoliduar një industri e prodhimit të videoklipeve dhe filmave muzikore. Ekzistojnë rrjete dyqanesh të shitjes së video, CD dhe kasetave muzikore, përveç një rrjeti prej 60-70 televizioneve lokale, rajonale dhe kombëtare që transmetojnë 24 orë muzikë. Kjo industri po investon drejt një kulture sa revolucionare në ndjekjen e trendeve bashkëkohore në disa raste, aq edhe banale në disa raste të tjera. Ajo ka nevojë për ekspertë, për artistë e dizainera, dhe për kritikë që ta përsosin këtë sektor dhe marrëdhënien social-kulturore në tërësi që ai gjeneron. Shpresoj që stafi dhe studentët e POLIS të japin një kontribut në këtë drejtim, qoftë dhe nëpërmjet botimeve të tilla modeste.

Ju uroj lexim të mbarë!



I → 0 ■ AM → 1 ■ A → 1A ■ CAMERA



© CONVERSION FZLIEMANS

I → 0 ■ AM → 1 ■ A → 1A ■ CAMERA



© CONVERSION PZL/UMANS



Fq 12-13: Poster i grupit Buggles;
Anash: Pjesë nga filmi muzikal "West
Side Storie"





VIDEOJA MUZIKORE

Videoja muzikore është një zhanër artistik i aplikuar, një film i shkurtër që integron një këngë me imazhe, e cila prodhohet për arsye promovuese dhe artistike. Ajo përdoret si mjet marketimi për të promovuar shitjen e regjistrimeve muzikore.


Origjinat e videove muzikore datojnë herët në histori. Ato dominojnë në vitet `80-të kur stacioni televiziv *MTV* u krijua në bazë të formatit të tyre. Terma të ndryshme për këtë zhanër përfshijnë: këngë të ilustruara, video këngësh, inserte filmike, promocione (film-promo), klipe promocionale ose klipe filmash, video klipe, video muzikore.

Për të realizuar videot muzikore përdoren një gamë e gjerë stilesh dhe teknikash filmimi, të cilat përfshijnë: animacionin, aksionin e gjallë, filmimin (si filmimi i aksioneve dhe aktrimeve), dokumentarë dhe qasje jo-narrative (si filmat abstraktë).

Këto stile shpesh përzihen dhe kombinohen me njëri – tjetrin, por në shumë prej tyre nuk interpretohen imazhe që kanë lidhje me lirikat e këngëve. Disa video të tjera nuk kanë një koncept të caktuar dhe shpesh janë versione të filmuara të performancave “live” të këngëve.



Sipër: Poster i grupit The Beatles; Poshtë: Simboli i zbërthimit të dritës në kopertinën e CD-së së grupit Pink Floyd



TRIPLE LANTERNS,
Prices from £25 to £100.

MAGIC LANTERNS
AND
Dissolving View Apparatus,
SLIDES, AND EFFECTS,
Of the Highest Class.


GOLD & SILVER MEDALS AWARDED (1884-5)
For Optical and Mechanical excellence.

Sole Maker of the Registered
TRIPLE LANTERN,
The Luke Bi-unial Lanterns,
And the 3-Wick Paraffine
PHOTOGENIC LANTERNS.

Prices—£3:10:0 to £10:10:0.

ILLUSTRATED CATALOGUES gratis, post-free to all parts of the World.

406, 66, & 456, STRAND; 54, CORNHILL, LONDON.






Sipas orës: Pajisja
Feneri Magjik; Mënyrat e
fuzionimit të pajisjeve
të kohës



Fq. 20: Kamera dore;
Logoja e studios së filmit
Warner Bros Pictures;
Fq. Max Fleischer me per-
sonazhin e tij të animuar,
Betty Boop;
Fq. 22-23: Lloje të
ndryshme të kamerave
të para





FRABA
1972




HISTORIA DHE ZHVILLIMI

Më poshtë jepen momentet më të rëndësishme të zhvillimit të këtij arti:

1894 - Publikuesit e muzikës së shkruar Edwart B.Marks dhe Joe Stern dhe elektrikisti George Stomas, promovuan në SHBA këngën e tyre *"The little lost child"*, duke përdorur një fener magjik. Kjo u bë duke projektuar një seri imazhesh të palëvizshme mbi një ekran, kombinuar njëkohësisht me performancë *"live"* dhe ky zhanër u njoh fillimisht si *"këngë e ilustruar"*.

1907-1917 - Konsiderohet si Epoka *"Pronoscene"* për shkak të teknologjisë së përdorur.

1926 - Filmat e shkurtër muzikorë *"Vitaphone"*, prezantohen nga *"Warner Bros"*, dhe zakonisht kishin kohëzgjatje 6 minuta të animacioneve me stil art-deco në sfond, kombinuar me superpozimin e filmimit të interpretuesit duke kënduar. Por videoja e parë, e vërtetë, muzikore u krijua në vitin 1930 :*"Spooney melodies"*. Më tej artisti i animacionit Max Fleischer prezantoi: *"Screen songs"*, një tip makine karaoke, duke ftuar edhe publikun të këndonte gjatë filmave të shkurtër vizatimorë. Ky koncept u përdor edhe me audienat e moshave të reja të tipit: *"high-school musical"*.




Vitet `30 - Fillojnë të shfaqen shembujt e parë të filmave të animuar nga *Walt Disney*: “*The Silly Symphonies*” dhe “*Fantasia*”. Filma të tjerë të njohur ishin edhe filmat vizatimorë dhe muzikal të “*Warner Brothers*” si: “*3 Pigs in a Polka*”, “*Hungarian Dances*”, “*Looney Tunes*” dhe “*Merrie Melodies*”, apo filmat e shkurtër muzikorë të performuesit të famshëm “*Cab Calloway*”

1929 - Këngëtari i blues Bessie Smith u shfaq në filmin e shkurtër “*St. Louis Blues*” që paraqiste një performancë të dramatisuar.

1940 - Muzikanti Louis Jordan bëri një film të shkurtër të këngës së tij për filmin “*Look out sister*”. Sot ai konsiderohet si paraardhësi i zhanrit të videos muzikore. Gjatë këtij viti klipet promovionale patën sukses. Ato ishin zakonisht filma me një këngë, të krijuara për pajisjet “*Panoram*” visual jukebox-es, si ilustrime të një motivi, zakonisht muzikë-jazz, por që u zhdukën si teknikë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Filmat Muzikore janë tjetër pararendës i rëndësishëm i videove muzikore dhe shpesh imitojnë stilin klasik të “musical-eve” të “*Hollywood-it*” midis viteve 1930-50. Shembuj të tillë si videoja “*Material Girl*” e Madonna 1985, nga Mary Lambert; - ose



"Candyman" e Christina Aguilera 2001, janë frymëzuar nga Jack Cole: "Diamonds are a girl's best friends", në filmin "Gentleman prefer blondes" me Marilyn Monroe. Edhe videoja e Michael Jackson "Thriller" apo "Bad" (nga regjizori Martin Scorsese) janë influencuar nga kërcimi i stilizuar (i njohur si "Zënkat") e filmit "West-side stories".

1956 - John David Wilson drejtoi "Petrushka" - program për filma të arteve të bukura, në programin e televizionit NBC "Sol Hurok" (Ora Muzikore) me orkestrën live të Igor Stravinsky.

1957 - Tony Bennett u filmua duke ecur përgjatë kompleksit "The Serpentine" në Hyde Park në Londër, për interpretimin në "Stranger in Paradise".

1959 - Por krijuesi i konceptit "video muzikore" ishte këngëtari Disc-Jockey J.P.Richardson (the Big Bopper).

Rritja e videos-muzikore si "koncept popullor" lidhej edhe me zhvillimin e "fenomenit të Televizionit". Kjo u mundësoi shumë yje të rinj të ekspozoheshin, jo domosdoshmërisht nëpërmjet industrisë së Hollywood-it, që kërkonte shumë kohë e përgatitje përpara se të tërhiqte publikun në biletari.

Adeste fideles

7 $\text{♩} = 96$


la | la | mi | la | si | mi | do | si | do | re |

5

do | si | la | la | sol | fa | sol | la | si | do | sol | fa | mi | mi |


10

mi | re | do | re | do | si | do | la | si | sol | mi | la | la | sol | la | si |



Adeste Fideles, këngë Krishlindjesh; Dezain i televizorit në fillesat e fenomenit

Reklama të filmave për fëmijë të shoqëruara me muzikë, Looney Toons dhe Spooney Melodies



Walt Disney me kukulla
të personazheve të tij, 7
xhuxhat dhe reklamë e
filmave të animuar Merrie
Melodies





Fq. 30: The Big Bopper duke performuar; Louis Jordan;
Fq. 31: Rreklamë për filmat e shkurtër Vitaphone



True to its Mark

VITAPHONE

PICTURES THAT TALK
LIKE LIVING PEOPLE

Through VITAPHONE you
SEE and HEAR the Greatest Entertainers
in the World To-Day

Swiftly—surely—dramatically—Warner Bros. VITAPHONE has revolutionized the whole world of entertainment.

It has transformed the screen from a silent shadow to a LIVING thing—vivid and vibrant with the voices and emotions of living people.

The Talking picture—yesterday a dream—has been crystallized into reality in VITAPHONE. The vision—the faith of Warner Bros. have wrought this epic accomplishment.

And now VITAPHONE brings to you the outstanding marvel of twentieth century entertainment—

See and hear **DOLORES COSTELLO**
in **"NOAH'S ARK"**
with **GEORGE O'BRIEN**

Most tremendous dramatic spectacle since the birth of motion pictures. Vast pageantry of moving masses of human beings. Epic love depicted against the shifting backgrounds of two worlds. The climax—the Deluge—ringing down the curtain on earth's most dissolute age!

"NOAH'S ARK"—see it—HEAR it—through VITAPHONE.

If it's not a Warner Picture
... it's not VITAPHONE

WARNER BROS. VITAPHONE PICTURES



INOVACIONI VIZUAL


1960-1967

Në fundin e viteve '50-të u krijua në Francë pajisja "Juke-box vizual", "Scopitone", e cila përfshinte filma të shkurtër të prodhuar nga artistët franceze: Serge Gainsbourg, Françoise Hardy, Jacques Brel, Jacques Dutronc, për të shoqëruar si sfond këngët e tyre. Makineri të ngjashme u prodhuan në Itali si "Cine-box", dhe në SHBA "Color-Sonic". Ozzie Nelson drejtoi dhe editoi videon "Travelin' Man" për të birin, po ashtu këngëtar, Ricky Nelson.

1964 - Filmi i shkurtër eksperimental i Kenneth Anger "Scorpio Rising", përdori këngë të famshme në vend të dialogjeve.

1961 - Manny Pittson përmes show-t kanadez "Sing Along Jubilee", më parë regjistroi muzikë audio dhe më pas e lidhi me instalime vizuale me muzikantë që këndonin me superpozim "lip-sync", duke kombinuar audion dhe videon bashkë.


1963 - Këngëtarin Kyu Sakamoto u shfaq në programin televiziv japonez ku këndoi këngët e tij më të mira, duke përfshirë hitin e tij internacional "Sukiyaki", nr.1 në programin "hit-parade" amerikane. Jan & Dean prodhuan "Surf City" një hit i verës dhe nr.1 në SHBA, i



filmuar në terren, në autostradën e bregdetit Paqësor në Malibu dhe në Kaliforninë Jugore.

1964 - "The Animals" bënë videon "House of the Rising Sun" një klip me cilësi të lartë ngjyre, në një studio të dizenuar posaçërisht dhe e pajisur me ekip superpozimi. Nga ana tjetër, "The Beatles" bënë filmin e tyre të parë "A hard Day's Night" drejtuar nga Richard Lester. Xhiruar bardh e zi dhe prezantuar 14 e transmetimeve në vende të tjera, kryesisht SHBA, duke promovuar këngë të reja pa u shfaqur vetë. Gjatë këtij viti prodhohen 10 videot e para filma promo të regjistruara bardh e zi nga Intertel (Britani e Madhe) në Twickenham-Film Studios. Këngët e filmave ishin: "We can work it out", "Day Tripper", "Help!", "Ticket to Ride", "I feel fine".

1966 - Filmat me këngë u transmetuan në "Hulla-Ballo" në SHBA, si dhe në "Top of the Pops" dhe "Thank you Lucky Stars" (Britani e Madhe). Video të tilla u përfshinë në "Red-cd album", dhe "The Beatles anthology DVD set". E njëjta strategji u përdor edhe nga "The Byrds" për promovimin e këngëve të tyre në Britani, "Set you free this time". Gjatë këtij viti realizohet filmi promociional i "The Beatles" dhe



"Top of the Pop" Show
(UK)
Video album / antologji
(The Beatles)
Filmat promociionale
bardh e zi
me kamera dore
(editim e xhirim
ritmik dhe reverse)

Klipe promociionale
me ngjyra e teknika
underground & avant garde
Filtrim në post-produksion
Video si art impresionist
Film televiziv (BBC)

regjistrimet bëhen shumë të sofistikuar duke përfshirë klipe me ngjyra, në video si *"Rain"* dhe *"Paper Back Writer"* drejtuar nga Michael Lindsay-Hogg (që drejtoi *"The Rolling Stones Rock'n Roll Circus"* dhe filmin e fundit të Beatles *"Let it be"*, i xhiruar ne ABBEY Road Studios), për t'u trasmetuar posaçërisht për *"Ed Sullivan Show"*. Vendndodhjet tashmë bëhen më të përpunuara, dhe ngjyrat më vibrante; përdoren më shumë kamera dore, editim ritmik, xhirime me lëvizje të ngadalta dhe filma me kthim mbrapsht (reverse).

1967 - Peter Goldman e çon filmin promociional në një stad tjetër, nëpërmjet klipeve promociionale me ngjyra: *"Strawberry fields forever"* dhe *"Penny Lane"*. Ai përdor teknika të huazuara nga filmat "underground" dhe "avant-garde" si ndriçim dramatik, filtrim në post-produksion, kënde kamerash të pazakonta, filmime reverse dhe lëvizje të ngadalta (slow motion). Meqë kryevepra të tilla nuk mund të performoheshin live, videot u konsideruan si një mënyrë shprehjeje impresioniste arti, më shumë si një stimulim performance të idealizuar apo narracioni. Gjatë këtij viti "The Beatles" bënë filmin e tretë, një projekt televiziv një-orësh si *"Magical Mystery Tour"*, i trasmetuar në BBC. Këtu dallohen sidomos klipe filmash si *"I (lost) am the walrus"* dhe *"Your mother should know"*.



Fq. 35:
Fragmente nga
video klipi i "House
of the Rising Sun"
nga The Animals;
Pajisja "Scopitone";
Fq. 36-37:
Kopertinat e
albumeve të
grupeve Sympathy
For The Devil,
The Rutles, The
Monkees, Jan &
Dean;
Fq. 38-39:
Fotoja ikonë e
grupit The Beatles



THE SCOPITONE

Juke-Box Color Sound Film Viewer

Cameca Production



The SCOPITONE transforms and expands the field of the JUKE-BOX substituting to the disk the filmed song. As important an innovation as the talking film was to silent movies, it brings the image to the sound, thus making it possible to see the greatest artists interpret the successes of the day.

- THE NEWEST IN AMUSEMENT
- FASTEST MONEY MAKER FOR OPERATORS
- THE FASCINATING JUKE BOX
- A HIGH QUALITY CLEAR-TONE PICTURE
- HIGH FIDELITY SOUND
- A LARGE VARIETY OF SELECTIONS
- A QUARTER PIER SELECTION
- LOW COST MAINTENANCE
- PROFITABLE INVESTMENT

For information in Canada, contact the exclusive Canadian distributor

GERARD THIBAUT

355 ST. PAUL STREET
TEL. 524-0549 CANADA QUEBEC, P. Q.



AG CITY

DEAN

S 1 & 2)

LRP-3339





KLIPET PROMOCIONALE

1967-1973

Gjatë viteve '67-'73 industria e videoklipit merr një profil të ri:

1960 - The Rolling Stones u shfaqën me video klipin e tyre të parë *"Not fade away"*.

1965 - "The Who" bënë klipe promociionale të ndryshëm, që përshinin *"I can't explain"*, *"Happy Jack"*, si pjesë e filmit *"Call me lightning"*, ku teknikat e filmimit janë bazuar në vrapime të shpejta dhe hedhje.

1966 - Bob Dylan prodhoi klipin e tij monokrom *"Subterranean homesick blues"*, filmuar nga D. Pennebaker, pjesë e filmit dokumentar *"Don't look back"*. Klipi përdor skeda e fjalë kyçe, duke shmangur performancën për tregim të këngës. "The Kinks" prodhuan gjithashtu një *"klip promociional kurth"* (plot promo clips) për këngën e tyre *"Dead End Street"*, e cila u refuzua të trasmetohej nga BBC me arsyetimin e "shijes së varfër". "Pink Floyd" bëhen pionerë duke prodhuar filma promociionale për këngët e tyre: *"San Francisco Film"*, drejtuar nga Anthony Stern. Po kështu dhe *"Scarecrow"*, *"Arnold Layne"*, dhe *"Interstellar overdrive"*, drejtuar nga Peter Whitehead, i cili bëri klipe të tjera pionere për "Rolling Stones" midis viteve 1966-1968, *"Have you seen your mother, Baby"* dhe *"Standing in the shadow"*.



1967 - "The moody blues" bëri video promo për këngën "*Nights in white satin*". Po këtë vit, hiti promocional "*A whiter shade of pale*" i "Procol Harrum" kombinon xhirime të grupit duke performuar në skenë me imazhe dokumentari nga lufta e Vietnamit, të ndjekura nga sekuenca surrealiste. "The small faces" bëjnë gjithashtu klipe promo të ndryshme që përfshinin "*Hey girl*" dhe "*Get yourself together*" me teknika klipi me ngjyrë.

1968 - "The Troggs" përdoren klipe promo monokrom si "*Love is all around*", duke kombinuar xhirime nga koncerti me elemente psiko-delike. Ndërsa, grupi muzikor "The Doors", dy studentë nga UCLA, Jim Morrison dhe Ray Manzarek bënë klipin e tyre debutues "*Break on though (to the other side)*", duke kombinuar ndriçim atmosferik, punim dhe editim, me kamera të drejtuar nga Mark Abramson i "Electra Records". Klipi i tyre i dytë "*The Unknown Soldier*", përfshiu gjithashtu figura grafike dhe foto.

Edhe pse më pak të rëndësishme, Australia dhe New Zealand ndoqën trendet e Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve. Që nga 1967 grupet muzikore filluan të përdornin videot muzikore për këngët e

1969

Candid stage
 Sekuenca artistike
 Muzikë dhe stil
 psiko-delik

1970

Performanca në TV Shows
 Live Shows & Dokumentarë

tyre. Pionerët e parë ishin grupi muzikor "The masters of apprentices" për këngën e tyre "Buried & Dead", duke përdorur (candid stage) xhirime të fshehta me sekuenca të veçanta artistike. Një tjetër klip australian i njohur i vitit 1967 është "The loved one" nga "The loved ones", i drejtuar nga Peter L. Lamb si pjesë e filmit "Approximately Panther".

1967 - Grupi "Whitehead" gjithashtu drejtoi "We love you" dhe një klip me ngjyra "2000 light years from home", si pjesë e albumit të tyre "Their satanic majesties request", i drejtuar nga Michael Lindsay Hog.

1968 - "Whitehead" bëri klipe për "Jumping Jack Flash" tek "The Rolling Stones Rock'n Roll Circus", dhe "Child of the moon" në klip me ngjyra e monokrom. Puna e tyre përfshin edhe John Lennon, Yoko Ono, Eric Clapton dhe Jethro Tull Band. "Stones" kooperuan edhe me Jean Luc Godart për filmin "Sympathy for the devil", në "Olympic Studios" Londër.

1969 - Lou Christie prodhoi "I'm gonna make you mine", ndërsa grupi "The Carpenters" i bashkohet hitit të "Beatles", "Ticket to Ride".

1969-1970 - Klipet e filmave dalin nga moda me stilin dhe muzikën e tyre psiko-delike, prandaj bandat muzikore preferuan të

Segmente të animuara të hiteve
Video të animuara
Klipe promovionale me truke kamerash
Efekte speciale dhe dramatizime të lirikave Woodstock
Festival Films

1971 /74

performonin në TV-shows, gjë që i bëri ata më tërheqës vizualisht. Ndërkohë disa artistë prodhuan dokumentarë të drejtpërdrejtë (live shows) përfshirë "The Beatles" në "Let it be", dhe "The Rolling Stones" në "Gimme shelter".

1971-74 - Drejtuesi i "The Sonny & Cher Comedy Hour", Chris Bear-de mobilizoi John David Wilson për drejtimin e segmenteve të animuara të hiteve të ri-interpretuara nga kjo dyshe. Këngët përfshinin "One Tin Soldier" nga Coven, "Black and White" nga "Three Dog Night" dhe "Brand New Key" nga Melanie. Më vonë Wilson vijoi më vetë prodhimin e shumë videove të animuara për artistë si Joni Mitchell, Bob Dylan dhe Jim Croce.

Rëndësia e klipit promovional vazhdoi të rritej me programet televizive si "The Midnight Special" dhe "Don Kirshner's Rock Concert" duke ndërthurur xhirime koncertesh me klipe, si dhe duke përfshirë truke kamerash, efekte speciale dhe dramatizime të lirikave të këngëve.

Filmi i "Woodstock Festival", dhe filmat e koncerteve të bëra gjatë fillimit të viteve 1970-të, si "Mad Dogs" e Joe Cocker; apo "Englishmen" dhe "Live at Pompeii" e Pink Floyd, etij dëshmojnë se

Teknika cross-cutting
në mënyrë ritmike
gjatë koncerteve
Video muzikore me
metrazh të gjatë
Klipe pop me
kolazhe psiko-delike

1970

Surf films në Australi
kombinojnë imazhet dhe
muzikën në xhirime të
posaçme, me këngë të
gjata e pa dialog

1971

filmat e koncerteve përdorën teknikën e cross-cutting në mënyrë ritmike.

1971 - Grupi avant-garde "The Residents" filluan të xhirojnë videon e parë muzikore me metrazh të gjatë (feature length) "*Vileness Fats*". Grupi krijoi video edhe për "*The Third Reich 'n Roll*", "*One Minute Movies*", "*Hello Skinny*", si dhe zbulimin e tyre përmes "*It's a Man's Man's Man's World*".

1970 - Filmi kult i Nicolas Roeg "*Performance*" përmban një sekuençë në të cilën ylli i filmit Mick Jagger bëri një interpretim të "*Memo From Turner*" kombinuar me kolazh psikodelik. Shumë vende me industri lokale pop kopjuan shpejt trendin e klipëve filmike promo.

1966-1976 - Në Australi, u realizuan në baza të rregullta filma promociionale nga performuesit-pop. Këngëtari Lynne Randell u paraqit në klipin e parë promociional për një vepër australiane e filmuar me ngjyra, ndërsa të tjerat zakonisht në këtë periudhë ishin bardh e zi, sepse Australia nuk kishte nisur përdorimin e TV me ngjyra deri në fillimin e viteve 1975.

1970-1971 - Muzikanti dhe prodhuesi i filmave australian Chris

Video low-cost
Xhirime me një sekuençë
Buxhete 200-300 \$
Filmime në prova dhe
sfond të ndriçuar fort

1972

Lofven realizoi filma promocoinalë (monokrome) për dy nga hitet më të mira australiane *"Eagle Rock"* e Daddy Cool dhe *"I'll Be Gone"* e Spectrum. Më tej zhanri *"Surf Films"* nga Bruce Brown, George Greenough dhe Alby Falzon janë të njohur, gjithashtu, për kombinimet e tyre inovative të imazheve dhe muzikës në xhirimet e surfrit të filmuara posaçërisht, të përpunuara me këngë të gjata, pa dialog shoqërues.

1972 - Filmi referencë i Greenough *"Crystal Voyage"* i përfunduar me një sekuençë të filmuar dhe përpunuar nga Greenough në këngën 23-minutëshe të Pink Floyd *"Echoes"*.

Po këtë vit klipi për *"John, I'm Only Dancing"* u realizua me një buxhet US\$ 200, dhe u filmua në provat e pasdites për shfaqjen e David Bowie *"Rainbow Theatre concert"* - që tregonte "Bowie & band" duke mimuar mbi regjistrimin me balerinët "The Astronettes" në skenë dhe me një ekran të ndriçuar si sfond. Klipi u refuzua nga BBC, të cilës iu dukën të pashije tonet e tepruara homoseksuale të filmit, edhe pse *"Top of the Pops"* e zëvendësoi atë me filmime motoristësh dhe balerinësh. Ndërkohë klipi i "Jean Genie", i prodhuar me vetëm US\$ 350, u xhirua në një ditë dhe u përpunua për dy ditë. Ai bashkonte pjesë filmike të Bowie dhe bandës së tij në koncert me

Fenomeni David Bowie
 Bashkëpunim me foto-
 grafë, skenografë dhe
 kostumografë
 Filma me ngjyrë, 16 mm

1972 /73

Video klipi si muzikë
 filmi (soundtrack)
 NJihet nga industria e
 filmit

1978

filmime kontrastuese të grupit në një studio fotografie, veshur me veshje skene të zeza duke qëndruar para një sfondi të bardhë.

1972-73 - David Bowie luajti rolin kryesor në një seri filmash promocionalë të drejtuar nga fotografi pop Mick Rock.

Në këtë mënyrë filmat bëhen piketa të rëndësishme për vetë zhvillimin e zhanreve muzikore në vitet 70-të, sepse bëheshin nga një fotograf profesional më shumë se nga një drejtues profesionist filmash apo TV. Në këto vite Rock drejtoi dhe përpunoi katër klipe, të gjitha të xhiruara në film me ngjyrë 16 mm, për të promovuar katër këngë të David Bowie "John, I'm Only Dancing", "The Jean Genie", "Space Oddity" dhe këngën e vitit 1973 "Life On Mars" (nga albumi Hunky Dory).

1978 - Prodhuesi kanadez i filmave Denis Koufoudakis krijoi EXIT - filmin "Super 8 student" që përshkruan luftën e të rinjve me zgjedhjet që duhet të bëjnë në një epokë të mbingarkuar me informacion si dhe mendimet ekstreme për vetëvrasje. EXIT paraqiste "Foreplay/ Long Time te Boston për "soundtrack" (muzikë filmi) dhe ishte një nga filmat" e parë u njoh në një festival internacional, ku mori "Çmimin e Nderit".









Fq. 45: Portret i këngëtarit David Bowie; Fq. 46-47: Pjesë nga video klipi i "Subterranean Homesick Blues" i Bob Dylan; Fq. 50-51: Kopertina të albumeve të grupeve: Pink Floyd, The Byrds, The Beatles, The Monkees, The Rolling Stones; Fq. 52-53: Teknika të animimit Logo të MTV; Simbol i grupit Pink Floyd










FILLIMET E TELEVIZIONIT MUZIKOR

1974-1980

AUSTRALIA

1970 - Serialet televizive *"Countdown"* & *"Sounds"* ishin tepër domethënëse në zhvillimin dhe popullarizimin e zhanrit të videove muzikore në Australi dhe në vende të tjera, duke përforcuar rëndësinë e klipeve muzikore si një mënyrë e promovimit të veprave në ngritje dhe hiteve të reja. Ish radio DJ - Graham Webb nxorri një serial TV javor për adoleshentët që u transmetua në kanalin ATN-7 të Sidneit në mëngjesin e të dielës, i quajtur *"Sounds Unlimited"*. Për të rritur audiencën Webb iu drejtua *"Seven newsroom"* të Russell Mulcahy dhe i kërkoi të xhironte filmime për të shoqëruar këngë të famshme për të cilat nuk ishin krijuar klipe të posaçme (e.g. Harry Nilsson's *"Everybody's Talking"*). Duke përdorur këtë metodë Webb & Mulcahy mbledhi një koleksion prej 25 klipesh për shfaqjen. Suksesi e inkurajoi Mulcahy të jepte dorëheqjen nga puna etij në TV duke u bërë një drejtues (regjizor) me kohë të plotë ku bëri klipe të ndryshme për artistë të shumtë australianë, duke përfshirë: Stylyus, Marcia Hines, Hush and AC/DC.

1973 - Mulcahy rivendoset në Britaninë e Madhe duke krijuar video muzikore të suksesshme për këngëtarë të njohur pop-i, përfshi: *"Making Plans For Nigel"* (1979) e XTC dhe videon e tij



referencë për *"Video Killed The Radio Star"* e The Buggles (1979) e cila u bë videoja e parë muzikore e trasmetuar në MTV në 1981. Emisioni *"Countdown"* (*Hit-Parade*) u bazua në një shfaqje-pop të viteve 60 në Australi *"Kommotion"* dhe në *"Top of the Pops"* të BBC, por në ndryshim nga homologu britanik, *Countdown* nuk u kufizua vetëm në përdorimin e videove muzikore.

1974 - Programi u hodh në transmetim disa muaj pas emisionit *"Sounds"*, dhe fillimisht u trasmetua disa javë para se TV me ngjyra të prezantohej zyrtarisht në Australi, duke u bërë një nga shfaqjet më të ndjekura në TV australiane. Teksa fitoi popullaritet, koordinatori i talenteve i *"Countdown"*, Ian "Molly" Meldrum dhe producenti Michael Shrimpton shpejt e kuptuan se "klipet e filmave" po bëheshin një komoditet i ri në tregun e muzikës. Pavarësisht nga buxheti i vogël, drejtuesi origjinal i *"Countdown"* Paul Drane mundi të krijonte disa video muzikore të paharrueshme posaçërisht për shfaqjen, duke përfshirë klipet klasike të filmave për hitet e AC/DC *"It's a Long Way to the Top"* dhe *"Jailbreak"*.

1978 - *Countdown* u bë i suksesshëm në Australi dhe vende të tjera morën formatin e tyre, për ta trasmetuar në 22 vende, bashkë me

Formati australian
Hit Parade përhapet
në 22 vende të tjera të
botës
Kombinim i videove me
performancat në studio

1978

TV-të europiane. Kompania hollandeze e transmetimeve televizive "Veronica" nisi versionin e saj të "Countdown", që gjatë viteve 1980-të kishte Adam Curry si prezantuesin e saj më të mirë. Ndërsa objektet dhe ekspertiza e ABC-tv i dhanë mundësi "Countdown" të prezantojë performanca studioje të rregullta nga artistë vendas dhe të ardhur - shfaqjeve rivale si "Sounds" u mungonin burimet për të mundësuar prezantimin e segmente të tilla, prandaj ato fillimisht përdorën thujse ekskluzivisht vetëm video muzikore.

ZELANDA E RE

Si Australia, edhe Zealanda e Re ishte një adaptues i ri i formatit të videove muzikore, me TV-show-n bazë "Radio With Pictures" premiera e të cilit u dha në TV2 në 1976. Gjithashtu, programi Ready to Roll, u transmetua për herë të parë po atë vit.

MBRETËRIA E BASHKUAR

1970 - Shfaqja britanike që kishte kohë që transmetohej në "Top of the Pops" filloi të transmetonte video muzikore, edhe pse BBC vuri limite strikte mbi numrin e videove të përdorura, prandaj një

Video klipi konsiderohet komoditet në treg (mall për shitje)
Hit Parade stimulon shitjet përmes klasifikimit
Miksim i formatit video me TV Show

Filma të shkurtër mikro-komedi
Lindin rock-operat
Shfaqen video kasetat

1979

1980

pjesë e mirë e videove do të rrisnin shitjet e këngëve teksa shikuesit shpresonin t'i shihnin përsëri në javën e ardhshme.

1980 - David Bowie shënoi këngën e parë nr.1 në Britaninë e Madhe, në gati një dekadë falë promos tërheqëse të drejtuesit David Mallet për *"Ashes to Ashes"*. Një tjetër grup që ia doli mbanë me këtë taktikë ishte banda muzikore Madness, që xhiroi në film 16x35 mm, duke i ndërtuar klipet e tyre si filma të shkurtër "mikro-komedi".

1974 - Banda muzikore "Sparks" filmoi një video promo për këngën *"This Town Ain't Big Enough for Both of Us"* nga albumi *"Kimono My House"*.

1975 - "The Who" nxorën filmin e tyre që paraqiste vetëm muzikë *"Tommy"*, të drejtuar nga Ken Russell, i bazuar në rock operan e tyre të 1969 me të njëjtin emër. Po këtë vit banda muzikore "Queen" porositi Bruce Gowers t'i bënte një video promo për këngën e tyre të re *"Bohemian Rhapsody"* për ta nxjerr në *"Top of The Pops"*, e cila u bë e famshme, sepse ishte xhiruar dhe përpunuar e tëra në një videokasetë.

1979 - Adaptimi filmik i *"The Alan Parker Project"* i "Pink Floyd" në albumin *"The Wall"* e transformoi konceptin e grupit në një labirint konfrontues dhe apokaliptik, imazhesh, tingujsh, melodish dhe

Animimi me plastikë /
baltë dhe video
Kombinim i inçizimeve
audio me filmime nga
vend-xhrimet e posaçme

1981

lirikash të stilizuara ekspresioniste. Nga ana tjetër shfaqja muzikore e Rrokut Britanik *"The Old Grey Whistle Test"* prodhoi një numër videosh pionere të bëra posaçërisht për programin midis viteve `70 dhe fillimit të viteve `80. Kjo përfshinte një video të Frank Zappa *"City of Tiny Lights"* e bërë duke përdorur *"animim me plastikë/baltë e video"* të realizuara më vonë edhe për performues si: Led Zeppelin, Genesis, Pink Floyd dhe Mike Oldfield. Producenti ekzekutiv i *"The Old Grey Whistle Test"* ishte Mike Appleton. Ndërsa Derek Burbidge dhe Kate Humphreys drejtuan dhe bënë video për shumë nga artistët, duke pasur audion si rëndësi primare. Gregg Baily ishte regjistruer për shfaqjen në vendxhirim. Drejtues e operatorë të tjerë kamerash ishin Martin Pitts ne SHBA dhe John Metcalfe dhe Tim Pope etj në Angli. Vendhirime nga gjithë bota ishin një pjesë e programit. Ndërsa Martin Pitts drejtoi klipe për Bee Gees që u transmetua në shfaqje.

Në SHBA grupi amerikan alternativë "punk rock" i njohur me emrin "Devo" krijoi shumë video muzikore të vetëprodhuara, që u përfshinë në projektin pioner *"The Truth About Devolution"* të drejtuar nga

Përdoret në ShBA animacioni kompjuterik
Video Concert Hall bëhet programi i parë TV në nivel ndërkombëtar dhe i paraprind MTV

1982

Sistemi i video kasetave kthehet në industri prodhimi
Shkatërrohet kultura e stilit dhe lançohet epoka MTV

1983

Chuck Statler. Videokasetat e nxjerra nga “Devo” ishin ndoshta ndër produksionet e para me format të gjatë. Gjithashtu, një nga videot e tyre, “*The Day My Baby Gave Me a Surprise*” ishte e para që përdori animacion kompjuterik dhe tradicional. Kurse “shock-rocker” Alice Cooper, publikoi një video të koncertit të tij “*Welcome to My Nightmare*”, duke reklamuar performancën intensive vizuale të saj. Alice Cooper kujtohet në këtë periudhë për krijimin e një nga videove të para muzikore promovuese për albumin e tij “*Along Came a Spider*”.

1979 - “*Video Concert Hall*”, krijuar nga Jerry Crowe dhe Charles Henderson, programi i parë internacional i videove muzikore në TV-të amerikane, që daton thuhetse 3 vjet para MTV.

1980 - Grupi nga Zealanda e Re “*Split Enz*” kishte arritur sukses me këngën “*I got you*” nga albumi “*True Colors*”. Më vonë grupi u bashkua me “*Blondie*” duke u bërë e para bandë ndërkombëtare, që prodhoi një set të tërë klipesh promocionale për çdo këngë të albumit, duke përdorur sistemin e video kasetave.

1981 - Programi i “*USA Cable Network*”, “*Night Flight*” u bë një nga programet e para amerikane që reklamoi këto video si një formë arti, duke transmetuar edhe lançimin e MTV për më se dy muaj.

Lançohet çmimi Grammy për videot muzikore
 Billboard Award gjithashtu vlerëson Video Concert Hall si programin e parë ndërkombëtar revolucionar të programuar me video klipe
 Fillon trasmetimet MTV


1984

Dy filma specialë përpara shfaqjes së MTV-së që kontribuan gjerësisht në zhvillimin e industrisë së video-klipeve. I pari ishte *"Shock Treatment"* (1981), një degëzim i *"The Rocky Horror"* shfaqje filmash, shkruar nga Richard O'Bryan. Ajo ishte një video komerciale, që shkatërroi kulturën e "stilit" duke u fokusuar në aspekte vizualisht më pak ambicioze dhe duke menaxhuar kështu një buxhet të vogël. Filmi tjetër ishte adaptimi i Ken Russell i muzikës dhe linjës historike të grupit muzikor "The Who" në albumin *"Tommy"* dhe klipin me buxhet të ulët *"The Ramone's Rock 'n Roll Highschool"*. Po gjatë këtij viti albumi i parë amerikan me video muzikore që u prodhua nga grupi muzikor "The Tubes", me emrin *"The Completion Backward Principle"*, drejtuar nga Michael Cootten, që përfshinte dy video të drejtuara nga Russell Mulcahy, *"Talk to ya letter"* dhe *"Don't want to wait anymore"*.


Ndër videot muzikore të tjera të para, ishte dhe klipi i Michael Nesmith, që bënte filma të shkurtër muzikore për *"Saturday night live"*. Ai është fituesi i parë i një çmimi *"Grammy"* për videot muzikore me prodhimin e videos muzikore *"Elephant Parts"*, drejtuar nga William Dear, ndërsa çmimi *"Billboard Award"* njohu *"Video Concert Hall"* si programimin e parë me video muzikore internacionale në një TV amerikan.


Billboard







Fq. 61: Logo të Billboard Awards; MTV; MTV Video Music Awards; programit Top of the Pops; Koperinë e albumit të grupit The Buggles; Fq. 62-63: Sekuenca nga video klipi i grupit Split Enz; Fq. 64-65: Koperina të albumeve të grupeve: Sparks; The Who; AC/DC; The Tubes; Devo; The Masters of Apprentice; albumi i këngëtarit Frank Zappa, ku përdoret animim me plastikë





Poshtë: Ilustrim i grupit AC/DC;
Anash Sipër: Bruce Springsteen duke performuar;
Anash Poshtë: Grupi Dire Straits duke performuar





VIDEOT MUZIKORE

PËRHAPEN NË MASË


1981-1991


Në vitin 1981 kanali amerikan i specializuar për transmetimin e videove, MTV, lançoi video-klipin muzikor *"Video Killed the Radio Star"*, duke filluar transmetim prej 24 orësh në ditë, muzikë në TV. MTV luajti një rol vendimtar në mesin e viteve '80-të në marketimin e muzikës më popullore. Shumë artistë të njohur të kohës në atë moment ia detyronin suksesin e tyre konstruktit mjeshtëror dhe joshjes së videove të tyre, përfshi Adam & Ants, Duran Duran, Madonna, ect. Në këtë periudhë dy inovacione kyç do të bëheshin faktor pozitiv për zhvillimin e videove muzikore moderne përfshi:

- 1) Zhvillimi i aparaturave të video regjistrimit dhe editimit relativisht të lira dhe gati për përdorim e zhvillim të efekteve vizuale të krijuara me teknika të kompozimit të imazheve.
- 2) Prezantimi i regjistruesve të videove me cilësitë lartë ngjyrash dhe video kamerat portative të cilat koinçiduan me dallgën e re të epokës.

Këto risi u mundësuan artistëve të pop-it opsionin që të prodhonin video promocionale më shpejt dhe më lirë, në krahasim me kostot e larta të prodhimit të filmave. Me zhvillimin e këtij zhanri, shumica e drejtuesve të videove muzikore iu drejtuan filmave 35 mm si mediumi i preferuar, ndërsa të tjerë miksuuan filmin me videot.

Megjithatë gjatë viteve '80-të videoja u bë tabu për shumicën






1981 - Lançohet edhe MTV Asia, duke rritur impaktin gjeografik.

1983 - Del në qarkullim videoja muzikore më e suksesshme, influencuese dhe ikonike; thuajse 40 minuta e gjatë për këngën e Michael Jackson, *"Thriller"*, e cila përcaktoi standarte të reja prodhimi, duke kushtuar gjysmë milioni dollarë amerikanë vetëm për t'u xhiruar. Ajo video bashkë me këngë më të hershme si *"Billy Jean"* dhe *"Beat it"* ndihmuan për lobimin e shfaqjes së videove të artisteve "afro-amerikane" në MTV. Deri në atë moment MTV konsiderohej si një kanal me muzikë të orientuar kryesisht nga rock-u. Nga ana tjetër, Rick James bën bujë duke deklaruar refuzimin e MTV në 1983 për të transmetuar videon e tij të *"Super Freak"*. Ankesa për racizëm erdhën edhe nga këngëtarë me ngjyrë.

1984 - Lançohet kanali *"Country Music Television"* CMT si dhe çmimi *"MTV Music Awards"*, që nënvizonte rëndësinë e MTV në industrinë e muzikës.

1985 - MTV lançon edhe *Channel VH1* (i njohur si *"Video Hits 1"*), që luante këngë më "soft" duke synuar demografi ndjekësisht



më të vjetër se *MTV*. Në këtë periudhë video kënga e Dire Straits, *"Money for nothing"* realizoi përdorimin për herë të parë të animimit kompjuterik duke e ndihmuar këngën të bëhej një hit ndërkombëtar. Në mënyrë ironike kënga ishte kritike ndaj fenomenit të videos në vetvete. Gjatë po këtij viti edhe kënga e Peter Gabriel, *"Sledgehammer"* përdori efekte speciale e teknika animimi të zhvilluara nga studioja britanike *"Aardman Animation"*, duke u shndërruar në një fenomen suksesi që mori 9 MTV Music Awards.

1986 - Një tjetër zhvillim në Industrinë e videove muzikore ishte lançimi në Britaninë e Madhe i *"The Chart Show"* në *"Channel 4"*, si një program që konsistonte plotësisht në produkte video muzikore dhe pa prezantues. Pra, deri atëherë videot ishin çështje e grafistëve të arteve kompjuterike, por në 1989 një shfaqje e tillë lëvizi drejt ITV.

1987 - Lançohet *MTV Europe*.

1988 - *MTV* debutoi me Show-n *"YO! MTV Raps"* duke e përkrahur për herë të parë muzikën *"Hip-Hop"* në një audiencë të madhe.













Fq. 72-73: Michael Jackson;
Fq. 74-75: Madonna;
Fq. 76-77: Grupi Queen
duke performuar;




CBCtelevision



NOT THE 9 O'CLOCK NEWS

Fq. 78-79: Logo të programeve muzikore
dhe stacioneve televizive muzikore



SUKSESI I REGJIZORËVE

1992-2004

1992 - MTV fillon të listojë regjizorët bazuar në kriteret artistike dhe cilësi kënge. Regjizorë si Michael Dondry, Spike Jonze, Stephan Sednaoyi, Mark Romanek dhe Hype Williams, filluan në këtë kohë që të sillnin një vizion dhe stil unik për videot që ata drejtonin. Disa nga këta të fundit, më vonë u bënë regjizorë filmi, ndërkohë që dalin në skenë regjizorë të rinj videosh si: F. Gary Gray, Lasse Hallstrom dhe David Fincher.

1995 - Dy video të drejtuara nga Romanek bëhen të njohura për shkak se janë 2 nga 3 videot më të shtrenjta të të gjithë kohërave: Michael & Jennet Jackson me "*Scream*", e cila kushtoi 7 milion dollarë për t'u prodhuar (mbetet videoja më e shtrenjtë e të gjithë kohërave) dhe kënga e Madonna-s "*Bed time stories*" e cila kushtoi 5 milion dollarë.

Po në këtë kohë MTV lançoi kanale në të gjithë botën për të shfaqur video të prodhuara në tregjet lokale si *MTV Latin America* 1993, *MTV India* 1996, *MTV Mandarin* 1997. Ndërkohë në 1996 *MTV 2* debutoi me video muzikore alternative dhe më të vjetra.

MTV liston regjizorët
e videove në bazë të
kriterëve artistike dhe
cilësisë së këngës

Regjizori Mark Romanek
realizon 2 nga 3 videot më të
shtrenjta në histori:
Scream i M&J Jackson, 7
mln \$
Bed time stories e Madonna-s
, 5 mln \$
Promovohen nga MTV kanale
rajonale në të gjithë botën:
MTV Latin America
MTV India
MTV Mandarin
Fillon trasmetimet MTV 2, me
muzikë alternative dhe gold

1992

1995







Fq. 81: Marilyn Monroe në "Diamonds are a girl's best friends", Madonna në klipin e "Material Girl" frymëzuar nga videoja e M. Monroe;
Fq. 82-83: Sekuenca nga video klipi "Bed time stories" i Madonna's;
Anash: këngëtari Prince duke performuar






INTERNETI BËHET VIDEO-MIQËSOR

2005-2013

Videot muzikore më të hershme në internet janë ato të “tipit bazuar tek IRC”, që regjistronin videot, ndërsa ato shfaqeshin në TV, dhe më pas i dixhitalizonin duke i ndryshuar mpg files, nëpërmjet kanaleve IRC. Në 1997 Website-i “iFilm” u lançua duke prezantuar video të shkurtra dhe muzikë, ndërsa “Napster” një shërbim ndarjesh file-sh “pear-to-peer”, që funksionoi në vitet 1999-2001, u mundësoi përdoruesve të përhapnin file-t e videove muzikore. Nga mesi i vitit 2000, MTV dhe shumë kanale të tjera thaujse e braktisën shfaqjen e videove muzikore në favor të “reality TV-shows” që kishin më shumë audiencë, falë iniciativës pionere të MTV-së, nëpërmjet shfaqjes “The real world”, 1992.

2005 - Lançohet websiti-t “Youtube” që mundësoi shikimin online të videove edhe më lehtë se sa “Google”, “Yahoo”, “Facebook” dhe “Myspace”. Disa artistë arritën sukses më së shumti, ose tërësisht online. E tillë ishte banda “Ok GO”, e cila fitoi famë për videon e këngës së tyre, “A million ways” 2005, dhe “Here it goes again” 2006, duke u bërë të parët e njohur kudo online. E përsërisin suksesin në 2010 edhe me videon e “This too shall pass”. Artistë të tjerë online ishin Soulia Boy, Tell ‘em, dhe Marie Digby.

2007 - RIAA i dërgoi një letër “Youtube” për të parandaluar shpër-




ndarjen e videove, duke marrë parasysh çështjen e të drejtave të autorit. Si rezultat pas bashkimit me *Google – Youtube* dhe *Riaa* arritën një marrëveshje për të paguar të drejtat e autorit. Kjo ishte e ndërlikuar pasi disa kompani shkarkonin vetë video muzikore si reklamim i lirë/falas, ndërsa disa të tjera e panë videon muzikore si vetë-produkt.

2008 - Edhe videoja e grupit muzikor "The Weezer", "Pork & Beans" u atraktua nga ky trend, duke u përfshirë në 20 personalitetet më të famshme të Youtube.

2009 - Videoja muzikore e "30 Seconds to Mars" e quajtur "Kings and Queens" shkarkohet në website-n e njohur *Youtube*, dhe po në të njëjtën ditë arriti mbi 100 milion shikues, si dhe pati gjithashtu 40 milion shikime në *Myspace*. Videoja u bë edhe videoja e javës në iTunes store dhe ishte një nga videot më të shkarkuara, duke marrë 4 nominime në "MTV Video Music Awards 2010", duke e bërë bandën në fjalë, grupin muzikor të rrokut më të nominuar në historinë e *VMA*.

2010 - Videoja e Lady Gaga, "Bad Romance" bëhet videoja më e shikuar në *Youtube*, në internet, dhe e të gjithë kohërave, me 130 milion shikues. Ajo pati mbi 430 milion shikues nga fundi i 2011, por u mund më vonë nga videoja "Baby" e Justin Bieber, me mbi 660 milion shikues.



2011 - Videoja e Jennifer Lopez, *"On the floor"* u bë videoja më e klikuar e një femre, me 530 milion shikues nga fundi i 2011.

2012 - Video e PSY, *"Gangnam style"* kapi brenda 7 muajsh 1.4 miliard klikime dhe u bë fituese absolute e *MTV Award* dhe e çdo çmimi.

Interneti u bë në këtë mënyrë tregu më i madh i fitimit të të ardhurave për videot e prodhuara në kompanitë e regjistrimeve. Prandaj edhe MTV siguroi hapësirë për shërbime të tilla, ndërsa AOL së fundmi krijoi edhe *"AOL Music"*, me një koleksion të gjerë reklamimi dhe trasmetimi videosh. *Apple* gjithashtu siguroi nëpërmjet *"iTunes store"* një selektim videosh muzikore falas me kompresim dhe me cilësi të lartë që mund të shihej nëpërmjet *iTunes* application, dhe fundi filloi të shesë video muzikore për përdorim *"iPod"*. Vevo ishte një website tjetër videosh muzikore

Psy me Gnamnam
Style kap 1,4 mld
klikime brenda
7 muajsh, fitues
absolut i çmimeve
MTV VMA, etj

2012

AOL krijon AOL Music
Apple krijon iTunes Store & Applications
përmes iPod
Youtube dhe Google promovojnë VEVO
si medium për video muzikën dhe
reklamimin
Në Hollandë evolon tradita Behind Closed
Doors përmes kanaleve VPRO, 3VOOR12
dhe teknikave Guerilla Film

2013 /15

që u lançua në 2009 nga disa publikues muzikë në kooperim me *Youtube* dhe *Google* duke ndarë të ardhurat vjetore të reklamimit.

Duke ndjekur zhvendosjen drejt transmetimit në internet dhe popullaritetin në rritje të siteve të videove të gjeneruara nga përdoruesit si *Youtube*, që nga 2006 prodhues filmash të ndryshëm filluan të regjistronin seanca live për t'u prezantuar në web. Si, Vincent Moon "*The take away shows*", platforma "*In the van sessions*"; ose prodhimi hollandez guerila i filmave (Dutch Guerrilla film making) si, *VPRO 3VOOR12*, duke ndjekur traditën e njohur ("*Behind*) *Closed Doors*". Klipe të regjistruara me shpejtësi të tillë janë bërë me buxhet minimal, duke ndarë estetikë të ngjashme, me lëvizjen e muzikës "*Lo-fi*" në fillim të viteve '90-të. Kjo njihet si metoda e vetme për artistët pak të njohur të muzikës, duke ia prezantuar veten një audience të gjerë të frymëzuar nga artistë të mëparshëm si R.E.M dhe Tom Jones.





Fq. 90-91: Evolimi i laptop-it, iPhone, iPod;
Fq. 92-93: Website të ndryshme muzikore dhe logo;
Fq. 94-95: Poster i grupit 30 Seconds to Mars;
Fq. 96: Simbol i grupit 30 Seconds to Mars;
Fq. 97: Sekuenca nga video klipi "Un in the air" i 30 Seconds to Mars



Yahoo! My Yahoo! Mail More New User? Sign Up Sign In Help Feedback

Y! MUSIC

HOME VIDEOS RADIO DOWNLOADS ARTISTS EXCLUSIVES

Week In Music

Celebs salute Obama, and Led Zeppelin reconsider their reunion

- THE WEEK IN MUSIC
- Barack Obama Songs

← Obama, Led Zep Week In Music

- Akon Age Debate Blender Burner
- All His Videos Kid Rock
- Who's Next? Eric Hutchinson
- Buy Concert Tix Britney Spears

ADVERTISEMENT

level 1

Top 100 Charts

Chart:

- Single Ladies (Put A Ring on It) Beyoncé

Who's Next?
Katy Perry

Who's Next?
Lady Gaga

Papa! Smash
Natasha Bedingfield

Updates

MY CONNECTIONS EVERYONE

Today

music beta by Google

4977 SONGS ADDED

MY LIBRARY ARTISTS 267 ARTISTS

New and recent

Songs

Artists

Albums

Genres

AUTO PLAYLISTS

Thumbs up

Recently added

Free songs

INSTANT MIXES

It could be Sweet Mix

PLAYLISTS

August 18, 2011

New Dio

Portishead

<p>Kenny Wayne Shepherd 24 SONGS, 2 ALBUMS</p>	<p>King's X 10 SONGS, 1 ALBUM</p>	<p>KMEDM 10 SONGS, 1 ALBUM</p>
<p>Korn 10 SONGS, 1 ALBUM</p>	<p>Lacerda 1 SONG, 1 ALBUM</p>	<p>Led Zeppelin 73 SONGS, 8 ALBUMS</p>
<p>Lenny Kravitz 11 SONGS, 1 ALBUM</p>	<p>Lily Allen 11 SONGS, 1 ALBUM</p>	<p>Lo-Pro 12 SONGS, 1 ALBUM</p>



vpro facebook
Aol.vevo



MUSE

This is Myspace.

Discover, share and connect to music from the world's largest streaming library.

Join New Myspace Sign In

Scroll this way →

stmyspace Sign In Discover Welcome to New Myspace. Sign in to listen to music.

Press Room Privacy Terms © 2013 Myspace LLC. All rights reserved.

YouTube gnam gnam style official video with most hits

GUIDE

PSY - GANGNAM STYLE (강남스타일) M/V

officialpsy 81 videos 1,865,833,940

8,550,977 957,009

6,774,270

Like About Share Add to

Published on Jul 15, 2012
 PSY - Gangnam Style (강남스타일)
 ▶ NOW available on iTunes: http://smarturl.it/psygangnam
 ▶ Official PSY Online Store US & International: http://psy.shop.braveworld.com

Source video Loading...
View attributions

- YouTube Mix - PSY - GANGNAM STYLE (강남스타일) MV
- Supercats - Episode 1 - The Funniest Cat in the World - Funny Cartoon
- YouTube Spotlight
- PSY - GENTLEMAN MV
- PSY (L HYUN) 오만막 내 스타일
- PSY - GANGNAM STYLE (강남스타일) M/V Making Film
- Michel Teló - Ai Se Eu Te Pego - Video Oficial (Assim vocé me mata)
- Bruno Mars - The Lazy Song [OFFICIAL VIDEO]



MasterChef

iTunes Store




THIRTYSECONDSTO

MAF



RS











MUZIKA COUNTRY

Videot e para muzikore të këtij zhanri vijnë nga Sam Lovullo, producent i serialit TV *"Hee Hav"*; Don William e 1973 *"The shelter of your eyes"* nga JMI records; dhe Filmi *"Galveston"* nga interpretuesi i country-pop Glen Campbell 1969. Koncepti i këtyre videove kombinonte histori të treguara me foto me performanca live. Në 1983 lançohet *Televizioni i Muzikës Country CMT*, për të promovuar posaçërisht videot muzikore country themeluar nga Glen D. Daniel, lidhur me makinerinë e prodhimit botëror të videove country në Hendersonville, Tennessee. Në të njëjtën kohë u krijua dhe konkurenti i tij më i madh, Nashville network TNN. Ndërkohë *CMT* filloi të shfaqë 24 orë në 7 ditë video të muzikës country, gjithashtu *TNN* e programoi veten edhe më shumë ndaj stilit të jetesës country. Konkuruesi i tretë doli në 1995 dhe njihet si *"Great American Country" GAC*.

Prodhohen filma me muzike country-pop
Prodhohen video ku kombinohen histori te treguara me foto me performance live

1969

Lançohet CMT Televizioni i Muzikës Country dhe industria e prodhimit të videove country në Hendersonville, Tennessee

1983

Krijohet konkurenca me TNN Nashville Network dhe GAC Great American Country

1995



Sipër: Stacioni TV muzikor GAC; Fq. 102-103:
Këngëtari i muzikës country Willie Nelson;
Fq. 104: Këngëtarë country duke performuar;
Fq. 105: Poster për këngëtarin country Johnny
Cash








MINNEAPOLIS AUDITORIUM

SAT APR 22


SHOW 8:30 pm



SMOKEY SMITH Presents

THE FABULOUS JOHNNY CASH SHOW

**JUNE CARTER
THE TENN. THREE
MOTHER MAYBELLE &
CARTER FAMILY
The STATLER BROS.
CARL PERKINS**



TICKETS ON SALE
DOWNTOWN TICKET OFFICE - MINNEAPOLIS
FIELD SCHLICK TICKET OFFICE - ST. PAUL
EVERY SEAT RESERVED **\$1.50 - \$3.00 - \$2.50 - \$2.00**

Presented by SMOKEY SMITH, the original legend of rock

FOR SHOW PRINT

Videot muzikore JOZYRTARE

Videot jo zyrtare, të bëra nga fansat, më të njohura si kasetat “*Bootleg*” janë bërë duke sinkronizuar filmime ekzistuese nga burime të tjera si filma, seriale televizive, me këngët. Videoja e parë e bërë nga fansat u krijua nga Kandy Fong në 1975, duke përdorur imazhe të palëvizshme nga filmi “*Star Trek*”. Me daljen e regjistruesve video-kaseta dhe shpërndarjen në internet të software të lirë për përpunim videosh, videot e krijuara nga fansat u bënë gjerësisht të përdorura në fund vitetet ‘90. Video të tilla shpesh njihen si *OPV*, “original promotional videos” – (video origjinale promovimi) duken nënkupuar “Other People’s Videos” – (Video të Njerëzve të Tjerë). Shpesh këto video përdornin materiale burimi të vizatuara nga filmat e animuar japonezë dhe amerikanë, por si muzika edhe filmimi nuk janë të licencuara, prandaj shpërndarja e videove të tilla është shkelje e të drejtave të autorit.

Një shembull mjaft i njohur i videove jozyrtare përfshin përzierjen (mesh-up) të paligjshme të këngës “*Danger Mouse*” së Jay-Z me pjesë muzike nga albumi i The Beatles, miksuar me filmime kërcimtarësh rap.

Në 2007 lindi një formë e re superpozimi (lip-sync) bazuar në videon muzikore të njohur me emrin “lip-dub”, në të cilën një grup njerëzish filmohen duke superpozuar mbi një spot të çfarëdoshëm, dhe më pas dublohen mbi audion origjinale të videos në post-përpunim. Shembuj

Lind zhanri i videoeve që përgatiten nga fansat (kasetat "bootleg")

Fenomeni ka një boom falë daljes së regjistruësve video kasteta dhe sotware-ve falas në internet
Videot emërtohen si OPV (Original Promotion Videos, ose Other People's Videos)
Kombinohet filmi i animuar me muzikë të pa licensuar

Krijohet zhanri Mesh Up (përzjerje)
Lind forma e re e superpozimit, Lip Sync / Lip Dub dhe Guerrilla Videos
Përhapje virale në Youtube

1975


1990 /95

2005 /07



të kësaj forme janë *"Jonas Vark"* ose *"Guerrilla type Lip Dub: Stockholm Michael Jackson's tribute"*. Video të tilla janë në shumë performanca dhe përçojnë ndjenjën e të qenit spontane dhe autentike, duke u përhapur viralisht nëpër sitet me pjesëmarrës masivë, si *Youtube*.



Fq. 107: Rregjistrues për kasetat bootleg;
 Fq. 108-109-110-111:
 Performanca Lip Bud










ÇENSURIMI

Videoja Muzikore është një formë e shprehjes artistike, si koncept dhe medium, por shpesh artistët janë çensuruar kur përmbajtja e videove të tyre është ose konsiderohet fyese. Natyrisht, çfarë konsiderohet fyese ndryshon në vende të ndryshme, duke u varur kjo nga legjislacioni lokal, traditat, religjioni dhe etiket. Zakonisht kompanitë regjistruese sigurojnë prodhimin e videove për artistët e tyre, por shpesh ato çensurohen pjesërisht ose ndalohen plotësisht, duke u varur nga përmbajtja.

1981 - *MTV* shfaq videoën e Olivia Newton-John' *"Physical"*, duke prerë fundin e videos, sepse këngëtarja shfaqej në bikini dhe zbulonte modelë meshkuj homoseksualë. Në të njëjtin vit *BBC* ndaloi videoën e Duran Duran *"Girls on film"*, që paraqiste femra topless duke luftuar në baltë dhe me nota fetishizmi seksual. *MTV* shpesh ndalonte transmetimin e videove me erotizëm të rëndë, si videoja e Laura Branigan *"Self control"* (1984); ose refuzim total të klipit të William Friedkin, për nudizëm dhe erotizëm të fortë.

1982 - Videoja e parë e ndaluar nga *MTV* ishte ajo për hitin e Queen *"Body Language"*, për shkak të mbulimit të vogël të trupit dhe pamjaftueshmërisë së veshjeve, nuk u konsiderua i përshtatshëm për audeincat TV-ve të kohës.



1983 - *Entertainment Tonight* bëri një debat në “*Rock Video Violence*”, duke eksploruar impaktin e dhunës në video tek të rinjtë e duke shqyrtuar video të Michael Jackson, Duran Duran, Kiss, Kansas, Billy Idol, Def Leppard, Pat Benatar dhe The Rolling Stones, ku Dr. Thomas Radecki nga “Koalicioni Kombëtar Kundër Dhunës” në TV, akuzoi biznesin e videove për dhunë të tepruar. Gjithashtu producenti i “*9 Tracks*”, Tom Lynch analizoi polemikën e dhunës në video, ndërsa artistë dhe banda të ndryshme u munduan të mbronin punën e tyre.

Megjithatë, disa artistë përdorën çensurimin si një mjet publiciteti. Programi televiziv *Top of the Pops*, për të çensuruar këngët i bëri presion artistëve të njohur për polemikat e tyre, prandaj ata prodhuan qëllimisht këngë fuqimisht polemike, si në rastin e Duran Duran “*Girls on film*” dhe “*Frenkie goes to Hollywood*”, me “*Relax*”.

1989 - Videoja e Cher, “*If I could turn back time*” u limitua në transmetim në orët e vona të MTV për të njëjtat arsye, ndërsa videoja e Sex Pistol, “*God save the Queen*” u ndalua nga BBC, sepse e quajti Britaninë e Madhe një regjim fashist. Ndërkohë videoja e Mötley Crüe, “*Girls Girls Girls*” u ndalua nga MTV, sepse kishte balerinë

1989
 BBC çensuron Sex Pistols për oponencë politike ndaj qeverisë
 MTV çensuron striptizmin dhe nudizmin

1991
 BBC, MTV, VH1 çensurojnë Michael Jackson për anti-semitizëm
 TNN dhe CMT çensurojnë videot country me dhunë familjare
 Hapet debat publik

1992
 Madonna bëhet artistja më e çensuruar për shkak të seksualitetit dhe religjionit
 MTV, CVN dhe Much Much çensurojnë sadomazokizmin dhe seksualitetin, përdorimin e kryqit dhe skena erotike në grup

komplet nudo në një klub striptize, duke e detyruar artistin të bënte një version të ri të videos të pranuar nga MTV.

1991 - Videoja e Michael Jackson, *"Black or White"* u hoq nga transmetimi për shkak të prekjeve të pavenda të artistit mbi veten, por videoja e tij *"They don't care about us"* u ndalua nga MTV, VH1, dhe BBC, për mesazhin e supozuar anti-semitik, dhe sfondin e vendosur në versionin e videos në burg. Ndërkohë super ylli i muzikës country Garth Brooks me videon *"The thunder rolls"*, gjithashtu u ndalua nga TNN dhe CMT, për shkak të ekspozimit të dhunës familjare, por nën presionin e shumë radiove dhe një debati kombëtar, ata u detyruan ta transmetonin videon pas disa kohësh. Në këto kushte, kjo video fitoi çmimin e vitit nga "Shoqata e Muzikës Country" dhe u cilësua nga MTV dhe CMT si një nga "100 Videot Muzikore më të Mira të Bëra deri Atëherë". Po në këtë vit kanali i fundit promovoi emisionin *"Late Nights Specials; Too Much for Much"* seri ku videot transmetoheshin e diskutoheshin pse ishin çensuruar.

Ndër të gjithë artistët e diskutuar, Madonna është artistja më e lidhur me çensurimet, kryesisht për shkak të marketimit të temës së seksualitetit, që nisi me videon *"Lucky Star"* dhe *"Like a virgin"*. Situata

BBC çensuron përdorimin e drogës dhe ekstazi
MTV ndalon trasmetimin e imazheve nga holokausti, Lufta e Gjirit, imazhet e urisë, ndotjes dhe terrorizmit
ëensurohet edhe abuzimi ndaj fëmijëve

1993

Robbie Williams çensurohet për grafikë agresive
Disa vende aplikojnë çensurimin gjatë orëve të ditës


2000

u përkeqësua më shumë me *"Papa don't preach"* dhe *"Like a prayer"*, duke rezultuar në kritikate rënda ndaj saj për shkak të imazheve fetare seksuale dhe të orientuara nga racizmi. Por videoja e saj *"Justify my love"* shkoi ekstrem dhe u ndalua plotësisht nga MTV dhe *"Canadian Video Network"* dhe *"Much.Music"* për sadomasokizëm ose seksualitet, veshje të kryqit dhe seks në grup.

1992 - Videoja e grupit muzikor The Shamen, *"Ebenezer Goode"* u ndalua nga BBC për shkak të ekspozimit të drogës, ekstazisë, e ngjashme me videon e Prodigy të 1997 *"Smack my bitch up"* dhe *"Fire starter"*.

1993 - Kënga e rokbandës australiane *"INXS"* *"The Gift"* u ndalua nga MTV për shkak të përdorimit të filmimeve nga holokausti dhe lufta e gjirit, përdorimi i xhirimeve të urisë, ndotjes dhe terrorizmit. Gjithashtu videoja e bandës metal *"Tool"* u ndalua nga MTV për shkak të çështjeve sensitive lidhur me abuzimin e fëmijëve.

2000 - Videoja muzikore *"Rock DJ"* nga Robbie Williams shkaktoi polemika për shkak të grafikave. I shfaqur duke shqyer lëkurën e tij me mishin e gjakosur, deri sa bëhet skelet, këngëtari provokon publikun në ekstrem. Videoja u ndalua të trasmetohej gjatë ditës,




dhe transmetohej vetëm pas orës 10 të natës, ndërsa në Republikën Domenikane u ndalua totalisht për shkak të deklaratave si video sataniste.

2001 - MTV ndaloi këngët e Bjork, *"Pagan Poetry"* dhe *"Cocoon"* të dyja të ndaluara për shkak të nudizmit, videot e këngës së Madonna, *"What it feels like for a girl"* dhe *"Erotica"* u ndaluan prej sadomazokizmit, kurse kënga e saj *"American Life"* për imazhe me polemika ushtarake në një kohë kur kish nisur lufta e Irakut.

2002 - Videoja *"All the things she said"* nga dyshja ruse t.A.T.u shkakoi polemika të thella për shkak të puthjes së vajzave të reja dhe akuzave pedofilike. Në të kundërt këngëtarët i kapitalizuan pikërisht polemikat duke e performuar puthjen në skenë, të shfaqura me bluza ku shkruhej "çensuruar".

2004 - Video e Maroon 5, *"This love"* gjeneroi debat për shkak të skenave intime midis Adam Levin e të dashurës së tij (po ashtu si tek *"Misery"*), duke i detyruar të nxjerrin video të dytë të auto-çensuruar me animacione kompjuterike.


2005 - Videoja e Eminem, *"Just loose it"* shkaktoi reagimin e



publikut dhe të Michael Jackson për akuzën e abuzimit me fëmijët, gjyqit dhe operacioneve plastike, duke rezultuar në ndalim nga *BET-Tv*. Po këtë vit autoritetet egjiptiane ndaluan mbi 20 video muzikore si të papranueshme për moralin mysliman, duke përfshirë videon e Eric Pryds *"Call on me"*; Marilyn Manson *"(s)AINT"* dhe videon e Justica, *"Stress"* mbi diskriminimin e rinisë së Afrikës Jugore.

2006 - Videoja e rok-bandës australiane Eskimo Joe, *"Black Finger Nails, Red Wine"* u ndalua gjatë ditës dhe u lejua në një orar të kufizuar gjatë natës për moshat mbi 15 vjeç, për shkak të temave kriminale, duke çuar në zëvendësim të videos, me një version të ri.

2010 - Videoja e 30 Seconds to Mars *"Hurricane"* u çensuroi për shkak të elementëve të dhunës, nudizmit dhe seksit, duke e detyruar bandën ta pastronte videon në mënyrë që të transmetohej për moshat mbi 18 vjeç. Po në këtë vit hapen fjalë se video e Lady Gaga *"Telephone"* ndalohej nga *MTV*. Pavarësisht mohimit të *MTV*, video u trasmetua vetëm në *European MTV*, sepse në SHBA u kritikua për agresivitet. Ndërkohë video *"Long game"* u ndalua nga programi muzikor australian *"Video Hits"*. Të njëjtin fat pati edhe videoja e Ciara *"Ride"*, e cila u ndalua nga *BET* dhe televizionet britanike për akuzime mbi seksualitetin. Videoja e Rihanna *"S&M"* u ndalua në 11 vende dhe u cilësua si e papërshtatshme për audiencat nën 18 vjeç.





Anash: Pikturat ikonë mbi fytyrat e anëtarëve të grupit Kiss; Sipër: Grupi Kiss;
Fq. 120-121: Kopertina të albumeve të grupit Frankie Goes to Hollywood; Olivia Newton-John
në këngën "Physical"; Robbie Williams në këngën "Rock DJ"; Kopertina e albumit të grupit
Queen

RELAX
FRANKIE GOES
TO HOLLYWOOD





"You are the
only person
I have ever
loved."



PRODUCED BY
JOHN YANIK

Directed and Scored by
Richard Donner
Dances choreographed by Bruce
Gardner, Les Landrum and George
Lukacs
Edited by Craig Hill and
Richard Dyer
The Executive Producer
Richard Dyer
Executive Producers
John Yarik and George
Lukacs
Music by Frankie Goes to
Hollywood
Music Supervisor
Peter Spalding
Hair: Sharon Rose, Gloria
Jane, Ripley, Tom Brown, C.O. Pompano
Styling: Tony, Paul, George
Pompano, Mark, Peter, George
Lukacs

robbie williams
rock DJ




QUEEN

A close-up photograph of a person's torso and shoulder. The skin is adorned with large, bold body paint designs. On the left side, there are three black arrow shapes pointing downwards. On the right side, there is a large red arrow shape pointing downwards, with a black outline. The word "QUEEN" is printed in large, bold, black capital letters at the top of the image. The background is a plain, light color.



© Rex Features




Fq. 122: Këngëtarja
Cher duke
performuar;

Fq. 123: Këngëtarja
Sinead O' Connor
duke grisur foton
e papës; Anëtarët
e grupit T.A.T.U,
Julia dhe Lena
duke u puthur në
skenë; Sekuenca
nga video klipi i
këngëtares Bjork,
"Pagan Poetry";
Fq. 124-125:
Ilustrim i
këngëtarit korean



Psy;
Fq. 126-127:
Psy duke
performuar
"Gnamgnam Syle"



싸이
PART

오빠
가
강남스타일,
야

GANG
ST

6甲

TI

PSY 馬







REFERENCA

- Banks, Jack (1996) *Monopoly Television: Mtv's Quest to Control the Music Westview*, Press, ISBN 0-8133-1820-3
- Clarke, Donald (1995) *The Rise and Fall of Popular Music*, St. Martin's Pressy, ISBN 0-312-11573-3
- Denisoff, R. Serge (1991) *Inside MTV New Brunswick: Transaction publishers* ISBN 0-88738-864-7
- Durant, Alan (1984). Cited in Middleton, Richard (1990/2002). *Studying Popular Music*. Philadelphia: Open University Press. ISBN 0-335-15275-9.
- *Frith, Simon, Andrew Goodwin & Lawrence Grossberg (1993) Sound & Vision. The music video reader London: Routledge, ISBN 0-415-09431-3*
- *Goodwin, Andrew (1992), Dancing in the Distraction Factory: Music Television and Popular Culture, University of Minnesota Press, ISBN 0-8166-2063-6*
- *Kaplan, E. Ann (1987), Rocking Around the Clock. Music Television, Postmodernism, and Consumer Culture, London & New York: Routledge, ISBN 0-415-03005-6*
- Keazor, Henry; Wübbena, Thorsten (2010). *Rewind, Play, Fast Forward: The Past, Present and Future of the Music Video*. transcript Verlag. ISBN 383761185X
- Kleiler, David (1997) *You Stand There: Making Music Video*, Three Rivers Press, ISBN 0-609-80036-1
- Middleton, Richard (1990/2002). *Studying Popular Music*. Philadelphia: Open University Press. ISBN 0-335-15275-9.
- Shore, Michael (1984), *The Rolling Stone book of rock video*, New York: Quill, ISBN 0-688-03916-2
- G.Turner, *Video Clips and Popular Music*, in *Australian Journal of Cultural Studies* 1/1,1983, 107–110
- Vernallis, Carol (2004), *Experiencing Music Video: Aesthetics and Cultural Context* Columbia University Press ISBN 0-231-11798-1